

8SH-2

596

PËRMBYSJA

DRAMË

BARDHOK SULEJMANI

854/82

S

S 96

BARDHOK SULEJMANI

« PËRMBYSJA »

Dramë në 4 akte

~~42439~~

1988

SHKURTËKA E SHITËR
SHKURTËKA E SHITËR

SHITËRIA BOTONJËSE -NAIM FRASHËRI-

DRAMËN UA KUSHTOJ CUCAVE MIRDITORE, QË, SI
SOKOLESHA TË VËRTETA, U ÇUEN KUNDRA ZA-
KONEVE PRAPANIKE.

AUTORI

PERSONAZHET:

- MARKA NOKA katundar.
MARA e shoqja
FRANI i biri, metalurg.
MARTINI i biri, metalurg.
LIZA e bija.
DAVA nusja e Franit.
NIKOLLI sekretari i organizatës bazë
të partisë në katund.
LEKA i ri në katund.
MARTA e re në katund.
PRENA e re në katund.
PJETËR JAKU shkesi.
GJOKË MUSTAKU dhandrri sipas zakonit.
SHKURTI, LLESHI katundarë të moshuem.
BARDHA, DILA katundare të moshueme.

Marrin pjesë të rinj e të reja, burra, gra.

Ngjarja zhvillohet diku në Mirditë në ditët tona.

«GJITHË PARTIA DHE VENDI DUHET
TË NGRIHEN NË KËMBË, TË DJEGIN
ME ZJARR E T'I KËPUTIN KOKËN
CILITDO QË MERR NËPËR KËMBË
LIGJIN E SHENJTË TË PARTISË PËR
MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË
GRAVE DHE VAJZAVE».

ENVER

AKTI I PARË

Në një kodër zhvillohet mbledhja e organizatës së frontit në katund mbas Fjalimit të shokut Enver të 6 shkurtit. Marrin pjesë burra, gra, të rinj dhe të reja. Atmosferë gazmore, dy cuca kërcëjnë një valle, një i ri i shoqëron me çifteli.

SHKURTI — A vazhdojmë mbledhjen, o shokë? (Lëvizje, fillojnë të zejnë vendet)

PJETRI — Paj për qiell e për dhe ma mirë të vazhdojshim kështu tue kërcye e tue ba qejf, se sa me ato mbledhje.

MARTA — (Në një anë Lizës) Ti, o Lizë, duhet të flasësh sot.

LIZA — Po si të flas, moj Marta?

PRENA — Ma mirë se asnjherë.

LEKA — Vetëm gëzim na pruni kjo parti, or burra, se nga e kaluemja s'trashëguem gja tjetër veç disa zakone të këqija.

MARKU — E pse flet ashtu, or Lekë Gjini, e ku po e len besën, trimninë e bujarinë, që i kemi pasun zakon brez mbas brezi.

LEKA — Mos u nxe, or Marka Noka, se ato që përmende ti do t'i ruejmë ndër shekuj.

SHKURTI — Rri një herë, or Marka Noka, se Leka foli kundra atyne zakoneve të damshme për të cilat folëm pak ma parë.

MARKU — Or Shkurt, zakoni zakon e ligji ligj. *(Të gjithë kanë zanë vend, vetëm Liza me të dy shoqet vazhdojnë bisedën më një anë.)*

MARTA — Ti mos u ul, folë oj Lizë, ti ke shka me thanë.

LIZA — Besa boll, oj Marta, po si të flas, a po e sheh tatën Mark?

NIKOLLI — *(Që e ka kuptue bisedën e tyne)* Folë, oj Liza e Marka Nokës, folë!

MARKU — *(Shikon rreptë nga e bija)* Kush more!

NIKOLLI — Mos u ul, oj Lizë!

LIZA — *(Tue u ulë ngadalë)* Jo, jo s'kam për të thanë gja. *(Shikon nga i jati)*

LLESHI — Me leje!

NIKOLLI — Po ti prit një herë, or Llesh Daka, ti fole një herë.

PJETRI — *(Me dinakëri)* Mos u ngut, or Llesh Daka, le të ndigjojmë edhe gratë tue kakarisë si pulat në kuvend të burrave. *(Disa qeshin, disa zemërohen)* U ka ardhë koha.

MARTA — *(Shumë e revoltueme)* Edhe unë jam dakord, se ne na ka ardhë koha. *(Ngrihet)*

NIKOLLI — Folë, oj Marta e Preng Lleshit, folë!

MARTA — Ndigjoni pra: Mue më kanë shitur me pare, (*reagim në popull*) ashtu siç shitet një lopë në pazar.

PJETRI — (*Nën za*) Po kësaj ç'i thonë, or Marka Noka?

MARKU — (*Nën za*) Turp për katundin tonë!

LEKA — Vazhdo, oj Martë, vazhdo!

MARTA — Nata e Shënarprenes për mue asht një natë e paharrueshme, një natë e zezë, se atë natë prindët bashkë me shkesin dhe mikun më çuen 50 mijë lekë, pazarllëku u zgjat shumë në mes të avullit të rakisë e tymit të duhanit. Kështu pra, unë Marta e Preng Lleshit, po e them këtu faqe të gjithëve se u shita për pesëdhjetë mijë lekë. Sa s'më ra pika. Thashë të mbytem... Por nuk u mbyta, se jetën time e shpëtoi partia... Rininë time e shpëtoi fjala e shokut Enver Hoxha. Ja ku po e them në këtë log të kuvendit se atë burrë nuk do ta marr, due të jem e lirë, due të mësoj që të bahem ma e vlefshme për familjen time, për katundin tonë, për partinë tonë. (*Duar-trokitje, urime, thirrje: «të lumtë, Marta» e tjera*)

PRENA — (*Nën za*) Lizë, ngrehu, se të erdhni radha.

LIZA — Jo, oj Prenë, nuk mundem.

MARKU — Mos i leni ato cuca të flasin ashtu, se na marruen katundin, or meca.

PJETRI — Nuk e kanë fajin cucat, or Marka Noka, por ata që i thërrasin në kuvend me burrat.

NIKOLLI — Simbas teje, or Pjetër Jaku, cucat mirditore duhet të shiten si berrat në pazar edhe tash e mbrapa.

PJETRI — Mos më fol kaq randë, or Nikoll Marku, paj edhe unë jam kundra zakoneve të vje-

tra, por ama të na përzihen cucat dhe gratë në kuvend të burrave, nuk e shof të drejtë, or ti.

PRENA — (Ngrihet) Edhe unë e prish fejesën ashtu si Marta. (Don të ulet)

LEKA — Oj Prenë, mos u ul, po na thuej edhe atë punën e «njeriut të bekuem».

PRENA — Po, unë i kërkova ndihmë Pjetër Jakut, si të afërmët tonë, që të më ndihmonte për këto që thashë...

PJETRI — (Çuditet) Mue!..

PRENA — Po, po, ty.

PJETRI — Paj pasha...

DILA — Ty të ndigjuem boll, or Pjetër Jaku, prit të flasin të tjerët.

PRENA — Siç thashë, i kërkova ndihmë Pjetrit që të më shpëtonte nga ajo fejesë e pavullnetshme, e ky më çoi ke Dom Zefi që të rrëfeshesha për mëkatet që fola. Dom Zefi, si Dom Zefi, me ato fjalë të urta e të buta u mundue të më bindte që unë t'i nënshtrohesha ligjeve të kanunit dhe porosive të tija, që për tanë jetën teme të bahesha robnesha e një njeriut që nuk e njifsha. Po e them në këtë kuvend të madh, që ta marrë vesh i madh e i vogël, se fejesën time e prish qysh sot.

MAKRU — (Ngrihet) Ndigjoni këtu, or meca: Unë po ju baj rixha që të mos përzihna në punët e fesë, por ma mirë të shikojmë hallet tona, për punë të Dom Zefit boll u fol edhe në fillim të mbledhjes, kot ta ngatërrojmë me këto. Simjet na duhet punë, bile punë e madhe, asht vjeti i parë i jetës kolektive, kemi hapun gjithë atë tokë të re, ajo do punë e jo llafe. Mandej ju e dini, bre burra, se partisë ja kemi dhanë fjalën që ta sigu-

rojmë bukën që këtë vjet, e fjala e dhanë duhet mbajtë.

LEKA — Sa për punën e Dom Zefit, s'jemi dakord ta lejmë, or Marka Noka.

MARKU — Ti, or Leka i Gjin Lekës, folë për veten tande ma mirë.

PJETRI — I kësaj mendje jam edhe unë, or burra, që Dom Zefin të mos e ngatërrojmë me këto llafe.

LEKA — Rri urtë, or Pjetër Jaku, se bash tek ai duhet kapë puna.

SHKURTI — Mana bash tek ai, ai dhe shokët e tij na lanë pa shkollë mue e ty, or Pjetër, e ju të tjerët, apo nuk asht kështu, or burra?

LEKA — Ajo dihet prej të gjithëve, o lalë Shkurti. E ç'na duhet neve prifti, kur kemi librin, gazetën, shkollën dhe vatrën e kulturës?

PJETRI — Si, or Lekë, ç'na duhet prifti!

LEKA — Ç'na duhet po, apo të duhet ty?

PJETRI — Jo, tybe!

LEKA — Po, tybe po, or Pjetër Jaku.

DILA — Kurse unë mendoj ndryshe: Dom Zefi qysh sot të shporret prej këndeje.

BARDHA — Dhe kishën ta bajmë shtëpi kulture, ku të gazmojë rinia.

(Reagime të ndryshme, shumica aprovuese)

PJETRI — More, për qiell!..

LEKA — Mbërthe kambët për tokë, or Pjetër Jaku, se tue u kapë me qiellin, po të rrëshqet toka nën kambë.

PJETRI — Po ti, or Lekë, mos ma fëlliq muhabetin.

LEKA — Po ti muhabetin e ke të fëlliqun qysh se po i del zot priftit.

PJETRI — Unë me i dalë zot priftit!

LEKA — Po, po, ti.

PJETRI — Mos folë ashtu, or Lekë, e çfarë lidhje kam unë me priftin xhanëm?

LEKA — Mendohu mirë, mendohu.

PJETRI — E po që të merret nëpër kambë puna e tij kot së koti, nuk e shof të drejtë.

SHKURTI — Kurse ato rrenat e tij herë shqip e herë latinisht i shef të drejta ti, or Pjetër.

NIKOLLI — Si thoni ju, or shokë, jeni të mendimit t'i japim fund punës së Dom Zefit, ashtu siç propozuen shoqet?

SHUMICA — Po...

NIKOLLI — Po ti, or Pjetër Jaku, si thue?

PJETRI — Po xhanëm, por unë them se grueja asht për me ndejtë në shtëpi e jo me ardhë e me nda gjyqe në kuvend të burrave. Paj edhe i moçmi e ka lanë një fjalë: «Flokëgjata, mendpakta».

MARTA — Tyt, na marsh të keqen! (*Revoltohen nga fjalët e Pjetër Jakut*)

NIKOLLI — (*Ngrihet i revoltuem*) Ti, or Pjetër Jaku, flet me gjuhën e priftit, me gjuhën e Dom Zefit. Pa pikë turpi çohesh e flet në atë mënyrë për gratë. Ato kërkojnë të drejtat e tyne, që mbrapambetja shekullore ua kish mohue, ato s'pranojnë të shiten ma e të mbahen si robnesha në shtëpi, e këto të drejta ua dha partia, ua dha fjala e shokut Enver.

Le t'ja bajmë pyetjen vetes, bre burra, a shitet fëmija, cuca?

SHKURTI — (*I prekun nga fjalët e Nikollit*) Po, or sekretar, unë e kam shitë sucën teme me